

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 945/16

Petrit PONARI
kundër Shqipërisë
(sibh tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 24 shkurt 2022 si Komision, i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,
Andreas Zünd,
Mikhail Lobov, *gjyqtarë*,
dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit*,
pasi mori në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 18 dhjetor 2015,
duke marrë në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur, në të cilën kërkohej përjashtimi i kërkesës nga lista e çështjeve,
pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit paraqiten në tabelën bashkëlidhur. Ai u përfaqësua nga z. B. Peka, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

Qeverisë së Shqipërisë (“Qeverisë”) iu komunikuan ankesat e kërkesit, bërë në mbështetje të neneve 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, në lidhje me moszbatimin e vendimit të brendshëm.

LIGJI

Pas negociatave të pasuksesshme për t’u arritur një zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se kishte propozuar të bënte një deklaratë njëanëshe për zgjidhjen e çështjeve të paraqitura me anë të këtyre ankesave. Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës ta përjashtonte kërkesën në mbështetje të nenit 37 të Konventës.

Qeveria e pranoi se moszbatimi i vendimeve të brendshme kishte shkelur të drejtat e kërkesit të garantuara nga neni 6§1 i Konventës. Qeveria pranoi t’i paguante kërkesit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur, dhe e ftonte Gjykatën ta hiqte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1 (c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së pagesës dhe do të shlyhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mospagimit të kësaj shume brenda afatit tremujor, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë ndaj shumës, që nga përfundimi i periudhës deri në shlyerje, në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes së pagesës plus tre pikë përqindje. Gjithashtu, Qeveria merrte përsipër të garantonte edhe zbatimin e vendimit të brendshëm respektiv për çështjen brenda së njëjtës periudhë tremujore.

Shlyerja e shumës dhe zbatimi i vendimit të brendshëm do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkesit iu dërguan kushtet e deklaratës së njëanshme të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Ai nuk i pranoi kushtet e deklaratës.

Gjykata vëren se neni 37§1 (c) i mundëson asaj përjashtimin e një çështje nga lista e saj, nëse:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Për këtë arsye, ajo mund t’i përjashtojë kërkesat në mbështetje të nenit 37§1 (c) sipas deklaratës së njëanshme bërë nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkesi dëshiron që të vijohet me shqyrtimin e çështjes (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme (shih, për shembull, *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004 dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009).

Sipas parashtrimeve në deklaratën e Qeverisë si edhe sipas angazhimit të Qeverisë që të zbatohet vendimin përfundimtar dhe për sa ka të bëjë me shumën e kompensimit të propozuar – Gjykata gjykon se nuk është e justifikueshme të vijohet me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1 (c)).

Sipas parashtrimeve të mësipërme, Gjykata vendos se në respektim të të drejtave të njeriut sipas Konventës dhe Protokolleve të saj, nuk i kërkohet që të vijojë me shqyrtimin e pjesës respektive të kërkesës (neni 37§1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata nënvizon se nëse Qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listë, në respektim të nenit 37§2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Sa më sipër, është me vend që kërkesa të përjashtohet nga lista e çështjeve për sa ka të bëjë me ankesën sipas nenit 6§1 të Konventës.

Në vijim kërkuesi u ankua sipas nenit 13 të Konventës për mungesën e zgjidhjes efektive në lidhje me moszbatimin e vendimeve të brendshme. Në mbështetje të fakteve të çështjes, deklaratës së njëanshme të Qeverisë dhe vendimit të Gjykatës për ta përjashtuar ankesën nga lista sipas nenit 6§1 të Konventës, Gjykata gjykon se çështja kryesore ligjore që ngrihet në kërkesën konkrete është zgjidhur. Për këtë arsye, ajo arrin në përfundimin se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet kjo pjesë e kërkesës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë së paditur dhe angazhimin për të garantuar përmbushjen e premtimeve të bëra në të;

Vendos ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve për sa ka të bëjë me ankesën në mbështetje të nenit 6 §1 të Konventës, sipas nenit 37§1 (c) të Konventës;

Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa tjetër e ankesës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 17 mars 2022.

Viktoria Maradudina
Zëvendësregjistrare e përkohshme

Peeter Roosma
Kryetar

SHTOJCË

Kërkesë e cila parashtrohet ankesa në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës
(moszbatimi ose vonesa në zbatimin e vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes	Emri dhe adresa e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratave të Qeverisë	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror dhe kostot dhe shpenzimet për kërkues (në euro) ¹
945/16 18.12.2015	Petrit PONARI 1963	Peka Besim Tiranë	5.10.2021	2350

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.